

LASGUSH PORADECI
Mbarim vjeshte
(nga vëllimi “Vallja e yjeve”)

Fluturoj dhe shtërg’ i fundit, madhështor, me shpirt të gjorë
Dyke shkuar që me-natë sipër malesh me dëborë...
Iku rënd’ e i përmallshmë, dhe me sqep të ti të fortë
Zotëriut q’i la folezën i trokiti mun në portë...

Pra më s’duket shpesh’ i fatit prapa bujqësh edhe plorësh,
Prapa brazdës së rrëxuar hap-me-hap prej qe malorësh;
Më s’dëgjohet nër ugare të kërcasë miu i hirtë,
Vdiq nepërka pikëlore ndaj blatisht’ e shkretëtirtë.

Dheri-i mardhur prej thellimi dirgjet heshtur nënë brymë,
Fryn veriu në pyll të thatë me zembrim e me fërtymë,
E si shtohet cinërima... ja! se ku dinak dh’ i voçërr
Nëpër gardhe-e nëpër ferra dërdëllet gazmor një çoçër!...

O! sa hir që kishte shtërgu, aq fisnik me shtat të gjorë,
Kur bariste dal-nga-dale — posi dhëndër me kurorë!...
E kur pranë-i vinte krilla, që shëndrij në krahëruar,
Me sy lart, me hap të matur — posi vash’ e nusëruar!...

